



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:268383

Datë: 30.08.2023

Numri i dokumentit: 04630984

**C-IV-20-0055**

*Ankuesi*

**M H-** Podujevë

*Përfaqësuar nga av N Th, Prishtinë.*

**Kundër**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, lagja Lakërishte- rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me 02 gusht 2023, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- 1. Aprovohet propozimi i përfaqësuesit të ankuesit, për tërheqjen e padisë.**
- 2. Konstatohet e tërhequr padia e ankuesit.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 04 gusht 2020, përfaqësuesi i ankuesit, parashtrij padi për kompensimin e borxhit. Sipas ankuesit me vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë me nr. C.nr.08/2003 të dt. 09.12.2003 për kompensimin e pagave të pa paguara AL-ja ka paguar vetëm 80% nga shuma neto ndërsa 20% nuk i ka paguar fare deri më tash. Padiësi me këtë padi kërkon nga Gjykata t’i pranohet e drejta e borxhit prej 20% e cila shumë është 4.000 € dhe drejtën e kamatës ligjore prej 8% prej ditës së vendosjes së AL-së me dt. 31.03.2015 e deri në vendosjen nga Gjykata. Padiësi i ka

bashkëngjitur padisë: autorizimin e përfaqësuesit, kopjen e nje listë të punëtorëve pa titull, vulë dhe nënshkrim, kopjen e vendimit të AL-së me numër PRN008-0107 të dt. 31.03.2015.

Më 10.09.2020, ankuesi ka bërë pagesën e taksës gjyqësore duke u bazuar në vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore të lëshuar nga DHPGJS.

Me 01 gusht 2023, përfaqësuesi i paditësit dorëzon pranë gjykatës Parashtrësë për tërheqjen e padisë duke theksuar se “une M H në marrëveshje me avokatin tim në bazë të nenit 261 të LPK-së e tërheqim padinë për kompensimin e shumës kontestuese” me arsyetimin se kanë arritur marrëveshje me AKP-në për çështjen kontestuese të lartëcekur.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e ankueses konstatohet e tërhequr.

Në bazë të nenit 3.1 të Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parashifet :

*Paditësi mund ta tërheq kërkesën apo ankesën e tij në çdo kohë me pajtimin e Dhomës së posaçme. Me dhënjen e pëlqimit të tillë, Dhoma e Posaçme merr parasysh interesin e të gjitha palëve të tjera .....*

Në këtë rast sipas deklarimit të përfaqësuesit të ankuesit arritja e marrëveshjes në mes palëve për shumën kontestuese është bazë për tërheqjen e ankesës e cila si e tillë nuk do të shqyrtohet derisa është realizuar qëllimi e ankuesit me marrëveshje.

Pra pasi që përfaqësuesi i palës ankuese me parashtrësë ka pohuar se ankuesi e bënë tërheqjen e padisë, gjyqtarja e çështjes konstaton se ankesa e ankuesit është tërhequr, ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore të lartcekura.

Andaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për ankesën e parashtruar.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, në pajtim me nenin 261.4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gj y q t a r j a  
**Hajrie Shala**